



Pranuar / Dorezuar Primi/eni/Prodato Received/Delivery	29.12.2022	viti god year	
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHAK	8561/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1029/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtar dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1029/2022 të datës 21.11.2022 e parashtruar nga ankuesi _____ përmes postës së Kosovës me numër R2482714 të datës 17.11.2022, me adresë, të Institucionit Ministria e Drejtësisë, kundër organit të punësimit Ministrisë së Drejtësisë, në çështjen juridike "Kompensim material-jubilare", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 29.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Detyrohet Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të bëjë shqyrtimin e kërkesës së datë 21.09.2022 të parashtruar nga ankuesi dhe të nxjerr akt administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- II. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Drejtësisë në pozitë "Zyrtar për Mbështetje të Viktimave të Krimit", në Divizionin për Mbështetje të Viktimave të Krimit-Departamentin për Drejtësi Tranzicionale dhe Kompensim të Viktimave të Krimit, sipas Akt emërimit të datës 01.07.2020, me datë 21.09.2022 ka parashtruar kërkesën me numër protokolli 12-908, tek

Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Drejtësisë, për kompensimin e shpërblimit të pagës jubilarë pas çdo 10 vjetëve të punës, i cili me datë 12.10.2022 përmes emailit zyrtar ka pranuar përgjigjen nga Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë, për refuzimin e kërkesës së tij, lidhur me mos kompensimin e shpërblimit të pagës jubilarë për 10 vjetët, më pas me datë 18.10.2022 përmes emailit zyrtar, i është drejtuar të njëjtës për nxjerrje të aktit administrativ për këtë çështje, të filluar me kërkesë.

Me datë 17.11.2022 ka parashtruar ankesë përmes postës së Kosovës me numër R2482714 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që është pranuar me datë 21.11.2022, me pretendime ankimore për kompensimin e pagës jubilarë-për 10 vite, në vazhdimësi në shërbimin civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 05.12.2022, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Drejtësisë. Më datë 09.12.2022 ka përcjell gjithë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesë A.nr.1029/202 me numër protokollit 7250/2022 e datës 21.11.2022; Pliko e postës së Kosovës 17.11.2022 me numër R2482714; kërkesë e datës 21.09.2022 me numër protokollit 12-908, drejtuar Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Drejtësisë; E-mail i datës 12.10.2022, përgjigje e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Drejtësisë; E-mail i datës 18.10.2022 nga ankuesi drejtuar Njesisë së Personelit; Vërtetim i datës 04.05.2016 për marrëdhënie të punës, e lëshuar nga Udhëheqësi i personelit të Komunës së Skenderajt; Akt emërimi datës 14.07.2014 lëshuar nga Komuna e Skenderajt; Njoftimi për dorëheqje e datës 04.07.2017 nga ankuesi drejtuar Zyrës së personelit në Komunë të Skenderajt; Akt emërimi i datës 04.08.2017 e lëshuar nga Ministria e Drejtësisë; Vendim Nr.33/2020 i datës 30.06.2020 mbi transferimin e ankuesit në pozitën aktuale, me Akt emërimin e datës 01.07.2020 e lëshuar nga Ministria e Drejtësisë; Pasqyra e nxjerr nga profili SIMBNJ-së nga ankuesi; Pasqyra e trustit e datës 31.10.2022, nga ankuesi; Përgjigje e datës 09.12.2022 numër protokollit 7819/2022 nga Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Drejtësisë, në kërkesën e KPMSHCK-së të datës 05.12.2022.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave për Vendosjen e kësaj çështje, duke u bazuar në nenin 16 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e parashtruara të lëndës dhe ka konstatuar që ekziston baza ligjore për të vendosur, duke obliguar organin e punësimit, respektivisht Udhëheqësin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë, që ti ndërmarr të gjitha veprimet, për të vendosur lidhur me kërkesën e ankuesit **SEPSE:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se ankuesi me datë 21.09.2022 ka parashtruar kërkesë me numër protokollit 12-908 tek Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë, për mes Drejtorit të DFSHP-së, për iniciimin e procedurës për pagesën e shpërblimit të pagës jubilarë për 10 vjet, pasi që me datë 22.08.2012 ka filluar punën në institucionet e Republikës së Kosovës, në mënyrë të vazhdueshme për dhjetë (10) vite.

Lidhur me këtë, përmes komunikimit elektronike E-mailit të datës 12.10.2022 Divizioni i



Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë i është përgjigjur në kërkesën e datës 21.09.2022, për refuzimin e kërkesës së ankuesit, me arsyetimin se, citoj: "... Ju jeni punësuar në Ministrinë e Drejtësisë me datë 04.08.2017 fillimisht në pozitën zyrtar ligjor në Departamentin Ligjor. Shpërblimet e përvjetorit jubilar parashihen në nenin 22 paragrafin 2 nën paragrafin 2.3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe neni 22 i Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet Tjera në Shërbimin Civil.....Divizioni i Burimeve Njerëzore pas shqyrtimit të të kërkesës suaj, konstaton se ju nuk jeni në marrëdhënie pune të vazhdueshme në shërbimin civil, për gjatë 10 vite, dhe si rrjedhojë e kësaj nuk ju takon shpërblimi i përvjetorit jubilar. Nga të dhënat nga dosja e juaj personale rezulton se ju me rastin e shkëputjes së marrëdhënies së punës nga pozita e juaj e më hershme në Komunë të Skenderajt, realisht keni pasur ndërprerje të marrëdhënies së punës, dhe si rezultat i kësaj nuk mund të konsiderohet si marrëdhënie e punës e vazhdueshme në shërbimin civil, ashtu siç përcaktohet me aktet ligjore të lartpërmenduar".

Ankuesi në ankesën e tij të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrë për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon nuk është shqyrtuar në mënyrë të drejtë dhe ligjore kërkesa e tij.

Nga administrimi i provave materiale, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ankuesi para se themelojë marrëdhënie pune me Ministrinë e Drejtësisë, i njëjti ka qenë në marrëdhënie pune në Komunën e Skenderajt nga data 22.08.2012, andaj duke marr parasysh këtë dhe të gjitha shkresat e lëndës, Kolegji i Këshillit, vlerëson se përgjigja e datës 12.10.2022 e Divizionit të Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Drejtësisë është në kundërshtim me nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse nuk janë shqyrtuar në mënyrë të drejtë pretendimet e ankuesit në kërkesën e tij. Po ashtu në mënyrë të pa argumentuar Divizioni i Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Drejtësisë pretendon se ankuesi ka pasur ndërprerje të marrëdhënies së punës, dhe si rezultat i kësaj nuk mund të konsiderohet si marrëdhënie e punës e vazhdueshme në shërbimin civil, ndërsa këtë konstatim e ka bërë pa u shqyrtuar në mënyrë të drejtë provat e lëndës, sepse nga provat e lëndës rrjedh se ankuesi më datë 04.08.2017 ka themeluar marrëdhënie punë në Ministrinë e Drejtësisë, ndërsa aktin apo njoftimin e dorëheqjes në Komunën e Skenderajt ankuesi e ka dorëzuar më datë 04.08.2017, si rezultat i kësaj nuk qëndrojnë pretendimet e Divizionit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Drejtësisë.

Kolegji i Këshillit, konstaton se Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Drejtësisë ka qenë e obliguar që sipas detyrës zyrtare, të kërkojë nga Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Skenderajt lidhur me kohëzgjatjen e marrëdhënies së punë së ankuesit në këtë institucion, respektivisht ky obligim rrjedh sipas nenit 86 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "Organi publik detyrohet, sipas detyrës zyrtare, të shqyrtojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes administrative".

Nga të cekurat si më lartë, Kolegji i Këshillit, konstaton se Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Drejtësisë, është e obliguar që të të shqyrtoj kërkesën e ankuesit të datës 21.09.2022 dhe të nxjerr akt administrativ në pajtim me nenin 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe të shqyrtoj në mënyrë të drejtë kërkesën e ankuesit si dhe të gjitha faktet që kanë të bëjnë me pretendimet



e ankuesit të parashtruara përmes kërkesës së tij.


Po ashtu Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Drejtësisë, me rastin e shqyrtimit të kërkesës së ankuesit është e obliguar që këtë ta bëjë edhe në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyres për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1029/2022.

Zyle Millaku Gojnovci

Procesmbajtëse

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

